

BASHKIA PEQIN

NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

"Blerje stabilizanti për rrugët rurale"

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT
(CPV):**

(Kodi CPV sipas objektit që do të vendoset në DST.)

VLERA E FONDIT LIMIT

4,166,666 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, fond i vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Peqin.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja "c", si dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Peqin ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas dokumenteve standarde të tenderit.
- b) Sigurimin e ofertës sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Sipas kushteve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit.

2.1.1

Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin ushtrimor, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKB-së.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenin 43 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi për regjistrimin e operatorëve ekonomikë.

Kjo kërkesë synon të garantojë se operatori ekonomik ushtron aktivitet në mënyrë të ligjshme dhe ka përmbushur detyrimet fiskale ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, duke garantuar seriozitetin dhe besueshmërinë e tij gjatë realizimit të kontratës.

2.2 Kapaciteti teknik

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për kontratat me sektorin publik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga autoritetet kontraktore për realizimin me sukses të kontratës, ku të evidentohen objekti, vlera, afati dhe realizimi i saj, ose fatura tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Për kontratat me sektorin privat:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara pranë organeve tatimore, ku evidentohen mallrat e furnizuara, vlerat dhe datat përkatëse.

Argumentimi

Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Qëllimi i këtij kriteri është të vërtetojë se operatori ekonomik zotëron eksperiencën minimale të nevojshme në furnizime të ngjashme dhe është në gjendje të realizojë kontratën në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Vlera prej **20 %** e fondit limit është plotësisht në përputhje me kufijtë maksimalë të përcaktuar nga legjislacioni i prokurimit publik dhe respekton parimin e proporcionalitetit, duke mos kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për stabilizantin objekt prokurimi.

Në rast se autorizimi lëshohet nga distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon lidhjen juridike ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të prodhuesit ose distributorit, si adresë, telefon, e-mail dhe faqen zyrtare të internetit, për efekt verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi

Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 44 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Duke qenë se objekti i kësaj procedure përfshin furnizimin me stabilizant që do të përdoret për stabilizimin e shtresave rrugore, Autoriteti Kontraktor duhet të garantojë origjinën e produktit dhe furnizimin nga një burim i autorizuar.

Autorizimi nga prodhuesi ose distributori garanton se operatori ekonomik ka të drejtën ligjore të furnizojë produktin, siguron gjurmueshmërinë e tij dhe minimizon rrezikun e furnizimit me produkte jashtë standardeve teknike.

Kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin e kontratës, nuk favorizon operatorë të caktuar ekonomikë dhe nuk krijon kufizim të konkurrencës, pasi çdo operator ekonomik mund të sigurojë autorizimin përkatës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skadat teknike të stabilizantit, të lëshuara nga prodhuesi.

Skadat teknike duhet të përmbajnë karakteristikat fizike, kimike dhe teknike të produktit, mënyrën e përdorimit, dozimin, kushtet e ruajtjes dhe parametrat teknikë që provojnë përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në rast se produkti disponon raporte testimi, deklarata konformiteti ose certifikata cilësie të lëshuara nga laboratorë ose institucione të akredituara, ato duhet të paraqiten bashkë me ofertën.

Argumentimi

Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 36 dhe nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 44 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Skedat teknike janë dokumenti bazë mbi të cilin Autoriteti Kontraktor verifikon nëse produkti i ofertuar përmbush parametrat teknikë të kërkuar.

Paraqitja e tyre është e domosdoshme për të bërë krahasimin objektiv ndërmjet ofertave dhe për të garantuar se produkti që do të furnizohet është i përshtatshëm për përdorim në stabilizimin e rrugëve rurale.

Kërkesa është plotësisht proporcionale me natyrën e kontratës dhe nuk krijon pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e mëposhtme për realizimin e kontratës:

- **2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës mbi 20 (njëzet) ton;**
- **2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës 10–14 ton;**
- **2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës 6–8 ton.**

Për mjetet e mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që provon disponueshmërinë e tyre në pronësi, me kontratë qiraje, ose çdo formë tjetër të ligjshme përdorimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin e mjeteve me qera, kontrata duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës ose të paktën të mbulojë afatin e ekzekutimit të saj.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenin 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor, përpara hartimit të dokumenteve të tenderit, ka analizuar nevojat konkrete për realizimin e kontratës dhe ka konstatuar se objekti i prokurimit nuk konsiston vetëm në furnizimin e stabilizantit, por edhe në transportimin e tij deri në segmentet rrugore rurale ku do të përdoret.

Rrugët rurale të Bashkisë Peqin paraqesin karakteristika të ndryshme teknike përsa i përket gjerësisë, pjerrësisë, kapacitetit mbajtës, rrezes së kthesave dhe kushteve të aksesit.

Për këtë arsye është e nevojshme përdorimi i mjeteve me kapacitete të ndryshme transporti.

Kamionët me kapacitet mbi 20 ton do të përdoren për transportin masiv të materialit nga pika e furnizimit deri në zonat ku infrastruktura rrugore lejon qarkullimin e mjeteve të tonazhit të rëndë.

Kamionët me kapacitet 10–14 ton do të përdoren për segmentet ku mjetet e tonazhit të lartë nuk mund të qarkullojnë për shkak të karakteristikave të rrugës.

Kamionët me kapacitet 6–8 ton janë të domosdoshëm për segmentet me gjerësi të kufizuar, kthesa të ngushta, ura me kufizime ngarkese ose zona ku përdorimi i mjeteve të rënda do të ishte teknikisht i pamundur.

Përcaktimi i **2 mjeteve për secilën kategori** është bërë pas analizimit të volumit të materialit që do të transportohet, shpërndarjes së vendeve të furnizimit dhe nevojës për realizimin paralel të furnizimeve në disa segmente rrugore.

Ky numër konsiderohet minimumi teknik i domosdoshëm dhe nuk tejkalon nevojat reale të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka lejuar që mjetet të disponohen në pronësi, me kontratë qiraje, ose çdo formë tjetër të ligjshme, duke garantuar respektimin e parimit të konkurrencës dhe mosdiskriminimit.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht personelin e mëposhtëm:

- **4 (katër) shoferë të pajisur me leje drejtimi të kategorisë C, të vlefshme.**

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- listëpagesat sipas legjislacionit në fuqi ose dokumentacion ekuivalent sipas DST;
- lejet e drejtimit të kategorisë C, të vlefshme;
- dokumentacionin që provon marrëdhënien e punës ose angazhimin e tyre për realizimin e kontratës.

Argumentimi

Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 të VKM nr.285/2021, i ndryshuar, me qëllim garantimin e kapacitetit minimal njerëzor për realizimin e kontratës.

Duke qenë se kontrata parashikon përdorimin e gjashtë mjeteve transporti, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se disponimi i **minimumi katër (4) shoferëve me leje drejtimi të kategorisë C** përbën kërkesën minimale të nevojshme për organizimin normal të procesit të furnizimit.

Numri i kërkuar është përcaktuar duke marrë në konsideratë mundësinë e organizimit të transportit në disa fronte pune njëkohësisht, nevojën për zëvendësimin e drejtuesve në raste mungese ose pamundësie objektive, si dhe respektimin e afateve të kontratës.

Kërkesa për leje drejtimi të kategorisë C është e detyrueshme, pasi sipas legjislacionit shqiptar për qarkullimin rrugor, drejtimi i mjeteve të transportit të mallrave me masën maksimale të autorizuar që tejkalon kufijtë e kategorisë B kërkon posedimin e kësaj kategorie lejeje drejtimi.

Përcaktimi i këtij kriteri nuk krijon kufizim të konkurrencës, pasi numri i shoferëve është minimal në raport me natyrën e kontratës, duke garantuar vetëm kapacitetin e nevojshëm për realizimin me sukses të furnizimit.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër transportin e plotë të stabilizantit deri në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, sipas grafikut të furnizimit dhe nevojave të Bashkisë Peqin.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **Deklaratë Angazhimi**, me anë të së cilës merr përsipër transportin e materialit deri në çdo segment rrugor që do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor gjatë zbatimit të kontratës, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Objekti i kësaj procedure nuk përfshin vetëm furnizimin me stabilizant, por edhe dorëzimin e tij në vendin e përdorimit. Për shkak se stabilizanti do të përdoret në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor rural të Bashkisë Peqin, Autoriteti Kontraktor nuk disponon kapacitete transporti për shpërndarjen e materialit.

Për këtë arsye është e domosdoshme që operatori ekonomik fitues të marrë përsipër transportin e materialit deri në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcional me natyrën e saj dhe nuk krijon kufizim të konkurrencës, pasi çdo operator ekonomik mund të organizojë transportin me mjetet e veta ose nëpërmjet mjeteve të marra me qira apo forma të tjera të ligjshme.

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë një pikë inertesh të pajisur me licencë/leje mjedisore përkatëse të kategorisë III.2.B, në pronësi ose me kontratë qiraje ose kontratë furnizimi të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.

Në rast se pika e inerteve nuk është në pronësi të operatorit ekonomik, ai duhet të paraqesë kontratë furnizimi ose kontratë qiraje të vlefshme, të shoqëruar me licencën/lejen mjedisore III.2.B të subjektit që do të furnizojë materialin.

Argumentimi

Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe lidhjes së drejtpërdrejtë të kriterit me objektin e kontratës.

Stabilizanti objekt prokurimi do të përdoret në kombinim me materialin granular ekzistues të trupit të rrugës dhe, sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor, gjatë realizimit të kontratës mund të lindë nevoja për furnizim të menjëhershëm me materiale inerte për korrigjimin e profilin të rrugës, plotësimin e shtresave, përzierjen ose sistemimin e bazamentit përpara aplikimit të stabilizantit.

Disponueshmëria e një pike inertesth garanton vijueshmërinë e procesit të punës, eliminon vonesat në furnizim dhe siguron që ndërhyrjet të realizohen sipas grafikut të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor **nuk kërkon që pika e inerteve të jetë domosdoshmërisht në pronësi të operatorit ekonomik**, por lejon edhe disponimin nëpërmjet kontratës së furnizimit ose kontratës së qirasë, duke garantuar kështu respektimin e parimit të konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit.

Kjo kërkesë konsiderohet plotësisht proporcionale me natyrën e kontratës dhe nuk përbën pengesë të pajustificuar për operatorët ekonomikë, pasi mund të plotësohet në disa forma të ligjshme:

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se garanton furnizimin e plotë me stabilizant sipas sasive të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, brenda afateve kontraktore dhe sipas grafikut të furnizimit.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër furnizimin, transportin dhe dorëzimin e mallit në çdo vend të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi

Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, me qëllim garantimin e realizimit të plotë të kontratës.

Për shkak të natyrës së objektit, ku furnizimet do të kryhen sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe jo domosdoshmërisht në një dorëzim të vetëm, është e domosdoshme që operatori ekonomik të garantojë disponueshmërinë e vazhdueshme të produktit dhe kapacitetin për ta transportuar atë në kohën e kërkuar.

Deklarata e angazhimit i shërben Autoritetit Kontraktor si garanci kontraktore për përmbushjen e detyrimeve dhe është plotësisht në përputhje me natyrën dhe objektin e procedurës së prokurimit.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Në hartimin e specifikimeve teknike janë respektuar parimet e konkurrencës së lirë, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor rural në administrim të Bashkisë Peqin, duke synuar përmirësimin e qëndrueshmërisë mekanike të shtresave rrugore, rritjen e kapacitetit mbajtës dhe uljen e kostove të mirëmbajtjes në periudhë afatgjatë.

Në specifikimet teknike nuk është përmendur asnjë markë tregtare, prodhues specifik, patentë, model, origjinë apo proces prodhimi që mund të favorizojë ose diskriminojë operatorë ekonomikë të caktuar.

Në rastet kur, për arsye teknike, është bërë referim ndaj një standardi, norme ose specifikimi teknik të caktuar, ai duhet të kuptohet gjithmonë i shoqëruar me shprehjen "**ose ekuivalent**", në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr.162/2020.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që çdo operator ekonomik që ofron produkte me karakteristika teknike të barasvlershme të ketë mundësi të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

Argumentimi i karakteristikave teknike të stabilizantit

Stabilizanti objekt prokurimi duhet të jetë produkt i destinuar për stabilizimin e rrugëve rurale me shtresa granulare, duke përmirësuar parametrat fizikë dhe mekanikë të trupit të rrugës.

Produkti duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim në kushte atmosferike të ndryshme dhe të sigurojë:

- rritjen e kapacitetit mbajtës të shtresës rrugore;
- reduktimin e pluhurit;
- rritjen e rezistencës ndaj ujit;
- uljen e deformimeve të sipërfaqes rrugore;
- rritjen e jetëgjatësisë së shtresës ekzistuese;
- uljen e nevojës për mirëmbajtje periodike.

Këto kërkesa burojnë nga nevojat reale të Autoritetit Kontraktor dhe nuk përbëjnë kërkesa favorizuese për ndonjë prodhues të caktuar.

Argumentimi i dokumentacionit teknik

Kërkesa për paraqitjen e:

- skedave teknike;
- certifikatave të cilësisë;
- deklaratave të konformitetit;
- raporteve të testimit (kur kërkohen);

është vendosur për t'i krijuar Autoritetit Kontraktor bindjen se produkti i ofertuar përmbush parametrat teknikë të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni bëhet i mundur krahasimi objektiv ndërmjet ofertave dhe verifikimi i përputhshmërisë së produktit me kërkesat teknike.

Kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin e kontratës dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës.

Argumentimi i transportit të materialit

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin furnizimin e stabilizantit në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, specifikimet teknike parashikojnë që transporti i materialit të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Ky detyrim është vendosur për të garantuar që materiali të dorëzohet drejtpërdrejt në segmentet rrugore ku do të kryhen punimet, pa krijuar kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Për shkak të shpërndarjes së segmenteve rrugore në zona të ndryshme rurale dhe largësive të ndryshme nga pika e furnizimit, operatori ekonomik duhet të organizojë transportin me mjetet e nevojshme, në mënyrë që furnizimi të realizohet sipas grafikut të punimeve.

Ky detyrim lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe nuk përbën kërkesë diskriminuese.